

AIDA përmbyll me sukses Forumin e Biznesit Japoni-Shqipëri në Tokio



Kompanitë shqiptare drejt Japonisë – për herë të parë

Më datë 20 shkurt, pranë Japan Bank for International Cooperation në Tokio, u mbajt Forumi i Biznesit Japoni-Shqipëri. Forumi u organizua nga Japan Institute for Overseas Investment (JOI) në bashkëpunim me Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe mbledhi përfaqësues të lartë institucionalë dhe biznesi nga të dy vendet.

Delegacioni shqiptar përbëhej nga Zv/Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit Z. Enkelejd Musabelliu, Zv/Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë Z. Erlind Sulo, Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s Znj. Laura Saro, CEO i Autoritetit Portual Durrës Z. Liburn Aliu dhe përfaqësues të TEDA Tirana.

Fjalën e mirëseardhjes e mbajti Presidenti i JOI, Z. Kenichiro Hayashi, i cili theksoi mundësitë e bashkëpunimit dhe rëndësinë e shkëmbimit të përvojave mes dy vendeve. Ambasadori i Shqipërisë në Japoni, Z. Ermal Muça, ftoi kompanitë japoneze ta konsiderojnë Shqipërinë si një destinacion të sigurt investimi, duke nënvizuar progresin drejt anëtarësimit në BE.

Nga pala japoneze, Drejtori i Departamentit të Dytë të Evropës në Ministrinë e Jashtme të Japonisë, Z. Shu Tamaura, vlerësoi marrëdhëniet dypalëshe dhe interesin e shtuar të kompanive japoneze për rajonin dhe Shqipërinë.

Znj. Laura Saro prezantoi potencialin e investimeve, ndërsa Zv/Ministri Sulo dhe Z. Aliu paraqitën zhvillimet në infrastrukturë dhe energji. Forumi vijoi me takime B2B.



AIDA dhe JETRO thellojnë bashkëpunimin për tregti dhe investime

Në vijim të përgatitjeve për Forumin e Biznesit në Tokio dhe intensifikimit të kontakteve me partnerët japonezë, Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, Laura Saro, zhvilloi një takim me z. Susumu Kataoka, President i Japan External Trade Organization (JETRO).

Diskutimi u përqendrua në rritjen e shkëmbimeve tregtare dhe nxitjen e investimeve japoneze në Shqipëri. Znj. Saro po ashtu theksoi potencialin e produkteve shqiptare për eksport, ndërsa Z. Kataoka shprehu gatishmërinë për të lehtësuar lidhjet mes bizneseve përmes platformave dhe misionëve të biznesit. Palët dakordësuan vijimin e bashkëpunimit për konkretizimin e projekteve të përbashkëta.



AIDA forcon bashkëpunimin me JICA për zhvillimin e SME-ve dhe rritjen e eksporteve

Në kuadër të Forumit të Biznesit Japoni-Shqipëri që do të mbahet në Tokio, Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s Znj. Laura Saro zhvilloi një takim me Z. Kei Toyama, Drejtor i Përgjithshëm i Departamentit Lindje e Mesme-Evropë pranë Japan International Cooperation Agency (JICA), për të diskutuar forcimin e bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve.

Bisedimet u fokusuan në zhvillimin rural, turizëm, punësim dhe mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Znj. Saro theksoi nevojën për programe trajnimi për SME-të shqiptare, në funksion të rritjes së eksporteve dhe procesit të integritimit në BE, në një fazë tashmë shumë të rëndësishme për Shqipërinë. Palët riafirmuan angazhimin për vijimin e bashkëpunimit konkret.



Shqipëria në BIOFACH 2026 – 10-13 Shkurt 2026 Nuremberg Messe, Gjermani

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) përmbylli me sukses koordinimin e pjesëmarrjes së kompanive shqiptare në panairin më të rëndësishëm të sektorit organik, të zhvilluar në Nuremberg, me mbështetjen e SIPPO Albania.

Përtej promovimit, pjesëmarrja e këtij viti u fokusua fort te përputhshmëria, certifikimi dhe pozicionimi “përtej organikes”. AIDA dhe SIPPO zhvilluam takime të targetuara me trupa certifikuese si ECOCERT dhe FairWild Foundation, si dhe skema të tjera të qëndrueshmërisë. Vëmendje e veçantë iu kushtua edhe skemave Fair for Life / For Life, duke adresuar komponentë sociale si pagesa e drejtë dhe qeverisja në zinxhirin e furnizimit.

BIOFACH shërbeu gjithashtu si një mundësi për të theksuar ofertën në zgjerim të Shqipërisë për përbërës me vlerë të shtuar, përfshirë ekstraktet superkritike CO₂, të cilat po fitojnë rëndësi në sektorët europianë të ushqimit, nutraceutikëve dhe kozmetikës.

Rezultatet e arritura:

250 takime me klientë nga BE

45 kontrata paraprake në proces

1.1 milion € vlerë e pritshme

Këto rezultate konfirmojnë potencialin e Shqipërisë si një origjinë konkurruese dhe e besueshme për përbërës organikë dhe të qëndrueshëm në tregjet ndërkombëtare.

Kompanitë shqiptare pjesëmarrëse në stendë ishin:

- Ekoprod sh.p.k
- Doci Oil sh.p.k
- Amel Extract Essential
- Natural Herbal E.R.V
- Feniks sh.p.k

AIDA falënderon kompanitë shqiptare pjesëmarrëse dhe ato që vizituan stendën kombëtare për angazhimin dhe përfaqësimin dinjitoz të Shqipërisë në një nga platformat më të rëndësishme globale të sektorit organik.

10-13 Shkurt 2026

Hall 4, Stand 529 | Nuremberg Messe, Gjermani

Një Traditë Suksesi në Promovimin e Produkteve Organike



Forumi i Biznesit dhe Ekonomisë Shqipëri-Sloveni

Në 5 Shkurt u zhvillua në Tiranë Forumi i Biznesit dhe Ekonomisë Shqipëri-Sloveni, një platformë kyçe për forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe krijimin e partneriteteve të reja mes dy vendeve. Në event morën pjesë përfaqësues institucionale, liderë biznesi dhe investitorë nga Shqipëria dhe Sllovenia.

Moment i rëndësishëm i forumit ishte dhe nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes AIDA dhe Spirit Slovenia, me qëllim forcimin e bashkëpunimit në drejtim të shkëmbimit të informacioneve, organizimit të aktiviteteve të përbashkëta dhe rritjes së investimeve në vendet respektive.



Gjatë forumit u mbajtën fjalime dhe prezantime nga:


- Zëvendësministri i Ekonomisë dhe Inovacionit, z.Enkelejd Musabelliu, i cili ftoi bizneset slovene të investojnë në Shqipëri, duke theksuar stabilitetin makroekonomik.
- Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro, prezantoi potencialin e investimeve dhe rolin e agjencisë si partner i investitorëve gjatë gjithë procesit, me procedurë të digjitalizuara dhe mbështetje institucionale të vazhdueshme.
- Ambasadori i Sllovenisë Jakob Štunf dhe Tine Kračun, CEO i Institute for Strategic Solutions, që theksuan rëndësinë e momentit për marrëdhëniet ekonomike dypalëshe.
- Mag. Nataša Kos, SPIRIT Slovenia, me fokus te ekonomia slovene, eksportet dhe inovacioni.



Forumi përfshiu gjithashtu dy panele diskutimi:

"Më të Fortë së Bashku" – Mundësi për integrimin europian dhe bashkëpunimit rajonal.

"Kur Tregjet Bashkohen" – Shndërrim i sfidave globale në mundësi zhvillimi, me fokus te financat, sigurimet, logjistika, inovacioni dhe Inteligjenca Artificiale.



Forumi theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ekonomik Shqipëri-Sloveni dhe mundësitë për zgjerim dhe investime afatgjata.

Mirëpritje dhe bashkëpunim konkret Shqipëri-Sloveni

Në zyrat e AIDA-s, Drejtoresha Ekzekutive znj. Laura Saro mirëpriti homologët e SPIRIT Slovenia pas nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit, në një takim ku u diskutua për planifikimin e eventeve të përbashkëta dhe konkretizimin e bashkëpunimit ekonomik mes Shqipërisë dhe Sllovenisë.

Në takim ishin të pranishëm Ambasadori Jakob Štunf dhe Mag. Nataša Kos (SPIRIT Slovenia), të cilët nënvizuan rëndësinë institucionale të këtij partneriteti.

Gjithashtu, përfaqësuesja e Celje Fair, si panairi më i madh në Slloveni, konfirmoi koordinimin për pjesëmarrjen e Shqipërisë me një numër të konsiderueshëm kompanish, duke reflektuar interesin e rritur për partneritete dhe projekte konkrete bashkëpunimi.

Ky takim tregon se dialogu, partneriteti dhe vizioni i përbashkët sjellin rezultate reale, duke hapur rrugën për iniciativa të reja dhe mundësi konkrete ekonomike mes Shqipërisë dhe Sllovenisë.



Në takim ishin përfaqësues të rëndësishëm të sipërmarrjes kosovare, ndër të cilët Z. Besart Dreshaj, Kryetar i LBK, si dhe përfaqësues të Lesna Group, Elsa Group, Alkolmplex Kosovë & Shqipëri, Spitali Lindja, etj.

Takimi u përqendrua në prezantimin e mundësive për partneritete ekonomike, rritjen e bashkëpunimit ndërmjet bizneseve të Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe diskutimin e iniciativave të përbashkëta, përfshirë organizimin e një Forumi të Përbashkët të Bizneseve të Shqipërisë dhe Kosovës.

Në përfundim të takimit, palët firmosën një Memorandum Bashkëpunimi, duke formalizuar një kornizë bashkërendimi për iniciativa të ardhshme dhe projekte konkrete me ndikim në zhvillimin ekonomik të dy vendeve.

Ky është një moment i rëndësishëm për thellimin e marrëdhënieve ekonomike dhe në krijimin e një platforme të qëndrueshme bashkëpunimi mes komuniteteve të biznesit të Shqipërisë dhe Kosovës.



Vizita e delegacionit të kompanive franceze në sektorin hekurudhor

Në ambientet e AIDA-s, u organizua një seminar mbi mundësitë e investimit në sektorin hekurudhor në Shqipëri, me pjesëmarrjen e një delegacioni prej 8 kompanish franceze lider në këtë fushë.

Takimi u hap nga Znj. Ornella Gjini, Drejtore e Drejtorisë së FDI-ve, Partneritetit dhe Kërkimit në AIDA, dhe u përshëndet nga Ambasadorja e Francës në Shqipëri, Sh.T. Znj. Catherine Suard, e cila theksoi marrëdhëniet shumë të mira dypalëshe dhe potencialin për bashkëpunim të mëtijshëm në infrastrukturën hekurudhore.

Firmoset Memorandum Bashkëpunimi mes AIDA-s dhe Lidhjes së Bizneseve të Kosovës

Më 26 shkurt 2026, Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), znj. Laura Saro, zhvilloi një takim me delegacionin nga Kosova, të përbërë nga përfaqësues të Lidhjes së Bizneseve të Kosovës (LBK), organizatë që përfaqëson mbi 2800 biznese nga sektorë kyç të ekonomisë.

Në fjalën e saj, Zëvendësministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Znj. Edona Bilali, nënvizoi ekspertizën franceze në këtë sektor dhe gatishmërinë për të thelluar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e praktikave më të mira.

Gjatë seminarit u prezantuan projektet kryesore hekurudhore në zhvillim, përfshirë Korridorin Adriatiko-Jonian, linjën Tiranë-Durrës dhe segmentin drejt Porto Romanos, si dhe projektet rajonale në bashkëpunim me Malin e Zi dhe Kosovën.

Takimi u mbyll me angazhimin e ndërsjellë për forcimin e partneritetit, shkëmbimin e përvojave dhe zhvillimin e bashkëpunimit në sektorin e transportit hekurudhor.



AIDA mirëpriti Ambasadorin e Republikës së Serbisë në Shqipëri

Drejtoresha Ekzekutive, znj. Laura Saro, zhvilloi një takim zyrtar me Ambasadorin e Republikës së Serbisë në Shqipëri, z. Slobodan Vukçević, ku në qendër të diskutimeve ishte pjesëmarrja e Shqipërisë në EXPO Beograd 2027.

Gjatë takimit, palët theksuan rëndësinë e këtij eventit madhor ndërkombëtar si një platformë strategjike për promovimin e potencialeve ekonomike, investuese dhe të biznesit shqiptar. U diskutua gjithashtu mbi organizimin e Pavionit të Shqipërisë në Expo 2027 Beograd dhe sfidës që ky projekt sjell për Serbinë dhe Ballkanin Perëndimor. AIDA nga ana e saj shprehu komplimentat institucionale për këtë organizim ambicioz ku Shqipëria do të ketë si insitucion përfaqësues dhe organizues të pavionit AIDA të eksporteve shqiptare.



Biznese që rriten me Mbështetjen e AIDA

Victoria Recruitment

Një hap i rëndësishëm përpara për Victoria Recruitment

Falë digjitalizimit dhe mbështetjes financiare nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve | AIDA, biznesi arriti të kalojë në një fazë të re zhvillimi.

Një shembull real suksesi se si mbështetja e duhur të çon në nivel tjetër.

Kantina Shehi

Kantina Shehi ndan rrugëtimin e saj të zhvillimit dhe ndikimin e mbështetjes nga grantet e AIDA-s.

Investimi në automatizimin e proceseve ka ndihmuar në rritjen e cilësisë së produktit, përmirësimin e efikasitetit dhe modernizimin e prodhimit.

Një shembull konkret se si mbështetja e duhur ndihmon bizneset shqiptare të rriten dhe të modernizohen.

Tradita Popullore

Tradita Popullore është një tjetër biznes që po transformon modelin e tij të zhvillimit falë mbështetjes nga grantet e AIDA-s.

Përmes zhvillimit të një platforme moderne e-commerce, biznesi ka arritur të zgjerojë kanalet e shitjes, të rrisë aksesin në tregje të ndryshme dhe të promovojë online veshjet tradicionale shqiptare.

Ky investim nuk përfaqëson vetëm një hap drejt digjitalizimit, por edhe një mënyrë për të mbështetur artizanët vendas dhe për të ruajtur e promovuar trashëgiminë tonë kulturore në tregun global.

Green Posta

GREEN POSTA ndan përvojën e saj mbi përfitimet nga grantet e Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

Mbështetja financiare ka mundësuar digjitalizimin dhe automatizimin e proceseve të brendshme të punës, duke rritur efikasitetin operacional, saktësinë e shërbimeve dhe shpejtësinë e përpunimit.

Një hap i rëndësishëm drejt modernizimit dhe inovacionit, që dëshmon se investimi në teknologji është çelësi për rritje të qëndrueshme dhe shërbime më cilësore në tregun shqiptar.

AIDA prezanton MatchMaker Albania për Këshilltarët Ekonomikë të Bashkimit European

AIDA prezanton MatchMaker Albania për Këshilltarët Ekonomikë të Bashkimit European – një platformë strategjike për investime, partneritete dhe bashkëpunim ndërkombëtar. Shqipëria hap dyert për biznesin europian!

Gjatë takimit u diskutua roli i këtij eventi në nxitjen e investimeve të huaja, zhvillimin e partneriteteve tregtare dhe forcimin e bashkëpunimit me aktorë ndërkombëtarë.



Match-Maker Albania – Edicioni II

Në kuadër të përgatitjeve për organizimin e eventit Match Maker Albania – Edition II, i cili do të zhvillohet më 26 mars 2026 në Pallatin e Kongreseve në Tiranë, u prezantuan katër zona tematike që synojnë të lidhin projektet shqiptare me investitorë dhe partnerë ndërkombëtarë.

Një ditë e dedikuar për prezantime projektesh, takime B2B & B2G, duke bashkuar liderë të industrisë, novatorë dhe investitorë që po formësojnë të ardhmen e Shqipërisë në 4 sektorë strategjikë:

- **Future Estate Zone**, me projekte në sektorin e pasurive të paluajtshme, zhvillimit urban dhe mikpritjes;
- **Smart Agriculture Zone**, e fokusuar në agrobiznes, iniciativat për cilësinë e tokës dhe financimin e bujqësisë së qëndrueshme;
- **Digital Horizons Zone**, që do të prezantojë inovacionin teknologjik, inteligjencën artificiale, fintech dhe startup-et; si dhe
- **Power Next – Energy Zone**, e dedikuar projekteve të energjisë së rinovueshme dhe financimit të investimeve energjetike.

Përmes prezantimeve të projekteve, sesioneve të pitching-ut, takimeve B2B dhe diskutimeve me investitorë, zhvillues dhe institucione financiare, eventit synon të nxisë bashkëpunime të reja dhe të promovojë mundësitë e investimit në sektorë strategjikë të ekonomisë shqiptare.



AIDA takim koordinues me ambasadorët shqiptarë jashtë vendit

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), me mbështetjen e Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), zhvilloi një takim koordinues me ambasadorët shqiptarë jashtë vendit, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe tërheqjen e investimeve të huaja cilësore në Shqipëri.

Gjatë takimit u prezantua versioni i rikonceptuar i e-Invest, platforma që thjeshton dhe e bën më të aksesueshëm procesin e investimeve për të gjithë aktorët institucionalë.

Po ashtu, u diskutua përgatitja e edicionit të dytë të MatchMaker Albania, eventit që lidh biznese, institucione dhe partnerë ndërkombëtarë, duke krijuar mundësi konkrete për bashkëpunime.

Ambasadorët shqiptarë do të luajnë një rol kyç në shpërndarjen e ftesave të investitorët në vendet ku janë të akredituar, duke i ftuar të bëhen pjesë e këtij eventit strategjik për investimet në Shqipëri.



AIDA hap thirrjen për Praktikë Studentore!

Je student ekselent dhe kërkon një mundësi për ta kthyer dijen në eksperiencë? AIDA të fton të bëhesh pjesë e ekipit tonë përmes programit të praktikës studentore!

Kjo është mundësia jote për të mësuar nga profesionistë, për të punuar në projekte konkrete dhe për të ndërtuar themelet e karrierës tënde.

Kush mund të aplikojë?

Studentë në vitin e fundit Bachelor ose Master, me mesatare 9.0 – 10.0, nga fushat:

- Ekonomi | Menaxhim Biznesi | Shkenca Politike
- Arkitekturë | Gjeodezi | Topografi | Design
- Dizajn Interieri | Dizajn Urban | Multimedia
- Statistikë | Ekonomiks | Financë | Gazetari
- Inxhinieri Informatike | Matematikë | Drejtësi

Çfarë kërkojmë në aplikim?

- CV
- Listë notash
- Vërtetim studenti
- Projekte ose punime (opsionale)

Kohëzgjatja e praktikës

- 3–6 muaj
- Fillon nga 15 Shkurti deri më 1 Mars

Çfarë përfiton?

- Eksperiencë profesionale
- Certifikatë për përfundimin e praktikës
- Letër reference
- Plotësim i praktikës së detyruar shkollore (kur aplikohet)
- Mundësi punësimi për studentët më të dalluar

Po kërkojmë individë që kanë:

- Kreativitet dhe sens estetik të zhvilluar
- Aftësi shumë të mira organizative
- Respektim të afateve
- Fleksibilitet dhe dëshirë për angazhim të vazhdueshëm

Nëse mendon se je gati për këtë hap profesional — AIDA po të pret!

Dërgoje interesin tënd në: info@aida.gov.al

AiSA invest in Albania

AIDA hap thirrjen për

Praktikë Studentore

Je student ekselent në vitin e fundit Bachelor/Master me mesatare **9.0–10.0**

Kjo është mundësia jote për të fituar eksperiencë dhe për të ndërtuar karrierën tënde!

3–6 MUAJ Praktikë

DEGËT E STUDIMIT

EKONOMI | MENAXHIM BIZNESI | SHKENCA POLITIKE
ARKITEKTURË | GJEODEZI | TOPOGRAFI | DESIGN
DIZAJN INTERIERI | DIZAJN URBAN | MULTIMEDIA
STATISTIKË | EKONOMIKS | FINANCË | GAZETARI
INXHINIERI INFORMATIKE | MATEMATIKË | DREJTËSI

Dërgoje interesin tënd në info@aida.gov.al

Na ndiqni:

#praktikestudentore

AIDA ju informon mbi thirrjen më të re të publikuar: FACTORY CHECK-IN

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: FACTORY CHECK-IN

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun: <https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/manufactury-factory-check-in>



AIDA ju informon mbi thirrjen më të re të publikuar: HERITAGE Cultural Heritage Innovation Grants

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: HERITAGE Cultural Heritage Innovation Grants

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun: <https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/heritage-cultural-heritage-innovation-grants-cr-eu-in>



AIDA ju fton të merrni pjesë në "Tourism Fair Albania"

Takime B2B që krijojnë partneritete

AIDA ju fton të bëheni pjesë e Takimeve B2B gjatë Tourism Fair Albania, një format i strukturuar që sjell në një tryezë biznesi aktorët kryesorë të sektorit të turizmit.

11-12 shkurt
Pallati i Kongreseve

Gjatë këtyre takimeve, do të keni mundësinë të zhvilloni takime të planifikuara një-më-një me:

- agjenci turistike dhe tour operatorë
- hotele, resorte dhe agroturizme
- kompani HORECA dhe teknologji
- shoqata, institucione dhe bashki

Fokus te zhvillimi i biznesit dhe promovimi i turizmit shqiptar

Mos e humbisni mundësinë për të zgjeruar rrjetin tuaj profesional dhe për të krijuar bashkëpunime me vlerë.



Kalendari i Panaiereve Ndërkombëtare – Hungari & Greqi 2026

Hungari & Greqi 2026 sjellin panaiere të rëndësishme ndërkombëtare, një mundësi ideale për biznese, investitorë dhe profesionistë shqiptarë për të krijuar lidhje të reja, promovuar potencialin dhe zgjeruar bashkëpunimet.

✦ Planifikoni pjesëmarrjen tuaj në kohë dhe qëndroni të informuar për eventet kryesore.

✉ Për interes ose informacion, kontaktoni: info@aida.gov.al

👉 Ndiqni kanalet tona për më shumë detaje